



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 70 prot.

Kamëz, më 28.8.2025

V E N D I M
Nr. 61 .Datë 25/8 2025

MBI

“MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJET DHE KULLOTAT E BASHKISË KAMËZ, PËR VITIN 2025-2027”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.08.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.57 Datë 20.08.2025 në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.57/20, “Për pyjet”, Ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,; Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar; VKM-së nr. 807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”, VKM-së nr.1080, date 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”, VKM-së nr.433, date 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave / bashkive”, ndryshuar me VKM-në nr.684, datë 02.09.2020, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota të Bashkisë Kamëz, për vitin 2025 - 2027”, sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatim Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave & Menaxhimit të Aseteve të Bashkisë Kamëz, Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe Njësitë Administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E KADASTRËS, BORDIT TË KULLIMIT, PYJEVE DHE
KULLOTAVE&MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË ASETEVE**

**PLANI PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN
E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2025-2027.**

Përpilimi i planit të masave për zjarret i referohet bazës ligjore të hartuar ndërvite dhe specifikisht po citojmë disa prej tyre:

Baza ligjore:

Ligji nr.139 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ligji nr.57/2020 “Për pyjet” neni 30, pika 3, 4, 5, 6.

Ligji nr.9693 datë 19.03.2007, i ndryshuar “Për fondin kullor”.

Ligji nr. 45/2019 datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

VKM -ja nr. 433, Datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave publike në pronësi të Bashkive, i ndryshur me VKM nr.684 datë 02.09.2020 .

VKM -ja nr.807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile”

VKM-ja nr.1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.

Plani i masave për zjarret në pyje konsiston në ndërgjegjësimin, parandalimin, eliminimin e zjarreve në pyje, si dhe merr në konsideratë anagazhimin e burimeve njërezore, mjeteve dhe burimeve finaciare.

Në planin e masave për zjarret, do të jenë të angazhuar drejtorja e kadastrës, sektori i bordit të kullimit, pyjeve dhe kullotave, Njësia Administrative Paskuqan, kryetarët e fshatrave afër sipërfaqeve pyjore, drejtorja e MNZ-së, drejtorja e emergjencave civile, me detyra të ndara specifikisht.

Disa të dhëna për sipërfaqet Pyjore.

- Sipërfaqja për të cilën disponojmë certifikatë pronësie është 154.02914 ha pyll.
- Vendndodhja e sipërfaqeve është Njësia Administrative Paskuqan.

- Fragment harte për vendndodhjen e sipërfaqeve Pyjore.

Me ngjyrë të gjelbërt është kufiri me njësitë vendore, Bashkinë Tiranë.

Ortofoto e përditesuar me sipërfaqet pyjore me nr.pasurie 1444/1, nr.pasurie 1444/2 dhe 1444/5.

Sipërfaqet pyjore për të cilat ne disponojmë çertifikatë, shtrihen në pjesën veri- lindore të njësisë Paskuqan, por duam të theksojmë që në krye të herës se shtrirja e tyre na çon në kufi me Njësinë Administrative Zall-Herr në veri, fshati Ferraj në lindje pjesë administrative e Bashkisë Tiranë.

Më poshtë harta topografike e pjesës së Njësisë Paskuqan dhe kufiri me njësitë vendore.




Ortofoto e përditesuar me sipërfaqet pyjore me nr.pasurie 1444/1, nr.pasurie 1444/2 dhe 1444/5.



Harta e ngastrave pyjore në pronësi të Bashkisë Kamzë (Njësia Paskuqan).



Harta me rrugët për përdorim mjetesesh zjarrfikës.



Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota.

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve, sipas kohës kur ndërmeren dhe me çfarë qëllimi , ndahen në :

- a. Masa preventive
- b. Masa përgatitore
- c. Masa direkte
- a. Masat preventive

Masat edukative, janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerzëve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet.

Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shkollorë, leksione të hapura për mbrojtjen e Pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, internetit, tv etj.

Masa informative- propagandistike, kanë si qëllim për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje, si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

Masat parandaluese që kanë të bëjnë me punimet në pyje, të projekteve apo miniprojekteve për të parandaluar zjarrin, si dhe masat gjatë shfaqjes së zjarrit. Pas eliminimit të vatrave të zjarrit pëpilohen projekte rehabilituese për sipërfaqen e djegur, keto varen nga lloji i zjarrit sipërfaqësor, nëntokësor, i kombinuar me zjarre në kurorat e drurëve pyjor.

Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen e zjarreve janë :

- Lloji i bimësisë
- Topografia
- Stina vjetore
- Karakteristikat klimaterike
- Komunikacioni.

Lloji i bimësisë është një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e rrezikut nga zjarret. Kështu pyjet halorë ndizen më lehtë se ato gjetherënës. Drurët dritëdashës janë më të rrezikuar kjo për shkak se përbërja e pyllit me këto lloje drurësh dhe është me i rrallë.

Kështu llojet e bimëve që ndizen lehtë dhe e mbështesin fuqimisht djegien, quhen specie bimore profibe (pishë , bredh etj).

Në rastin e pyjeve të Paskuqanit, ju informojmë se këto pyje janë shkurre dhe përbëhen kryesisht nga mare dhe shqopë, që janë më pak të ekspozuara nga zjarri.

Topografia apo relievi i terrenit , së bashku me llojin e tokës luan një rol të rëndësishëm në shkallën e ndezshmërisë të materialit djegës.

Në përgjithësi në terrenet të cilët kanë reliev të fortë, me orientim nga jugu është lehtësisht më i ndezshëm, se ai i orientuar nga veriu, kjo edhe për vetë faktin e bimësisë që rritet në të.

Stinët me karakteristikat e tyre ndikojnë në ndezshmërinë e pyjeve.

Vlera me temperatura të larta të ajrit, dhe periudha të gjata pa shi e ritin shkallën e ndezshmërisë në pyje/kullota. Në këtë periudhë bari thahet lagështia e tokës zvogëlohet në mënyrë drastike dhe përbën rrezik për zjarr.

Kështu kjo periudhë quhet periudhë kritike e vitit për shfaqjen e zjarreve në hapësirë të hapur. Edhe gjatë periudhës së dimrit, për shkak të temperaturave shumë të ulta kryesisht kur dimri është i thatë, për shkak të lagështisë së ulët të tokës, materiali djegës mund të ndizet lehtësisht.

Komunikacioni. Ashtu sic kemi vënë re, shkaku kryesor i zjarreve (me apo pa qëllim) është njeriu. Hapja e rrugëve në zonat e pyjeve apo në afërsi të tyre përdorimi për piknik, rekreacion mbledhjen e produkteve të ndërmjetme pyjore përbënë rrezik për zjarr.

Por nga ana tjetër pavarësisht efektit negativ, është edhe ai pozitiv i cili mundëson një kontroll më të mirë të zonës apo qasje më të shpejtë të zjarrfikseve dhe automjeteve në rast zjarri.

Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota.

Detyrë qytetare e cdo individi, në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpejtë të jetë e mundur institucionet përgjegjëse, banorët e lagjeve më të afërta me pyjet, kryepaqësitë e kanë për detyrë ligjore dhe qytetare për të bërë njoftimin dhe të kontribuojnë për pasuritë pyjore.

Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmbajtja varet suksesi i aksionit të shuajtjes së zjarrit, në qoftë se bashkia do të kishte fonde të mjaftueshme do kishte marrë punonjës me kontratë që do të kryenin detyrën e vrojtus-sinjalizues.

Hapat që duhet të ndërmerren janë:

1. Telefononi nr 128 pa pagesë i Shërbimit Zjarrfikës.
2. Prezantoni veten me emër e mbiemër.
3. Tregoni se ku jeni (vendndodhjen e saktë).
4. Tregoni vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orientuese më të sakta, emrin e vendit vendbanimit më të afërt apo objekte të njohura)
5. Tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar etj)
6. Nëse vëreni diçka të dyshimtë afer vatrës së zjarrit psh automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend.
7. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin veproni, në të kundërt largohuni në një distancë të sigurt.
8. Me qëllim që të kuptoheni me personin në telefon, jeni të lutur të flisni qartë dhe ngadalë. Informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i saktë, dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme. Përcaktimi i vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qënë i qëllimshëm etj.

Si do të shpërndahen masat:

- Hartimi i projekteve apo projekteve pjesore për të minimizuar rrezikun nga zjarret.
- Përcaktimi i masave kundrazjarrit, ngritja e shtabit të menaxhimit të Zjarreve në pyje **Maj-Nëntor të çdo viti.**
- Sensibilizimi, ndërgjegjësimi i komunitetit afër sipërfaqeve pyjore dhe në shkallë Bashkie **Maj- Nëntor të çdo viti.**
- Ngritja e skudrave zjarrfikëse dhe vrojtues sinajlisues për zjarret në pyje brenda **muaj Maj të çdo viti**
- Gadishmëria e mjeteve zjarrfikëse dhe burimeve njerëzore, për gjithë periudhën **Maj-Nëntor të çdo viti.**
- Përcaktimi i hartës së riskut për sipërfaqet pyjore.

Puna e kryer për vitin 2025.

- 1- Kemi kërkuar nga njësia administrative Paskuqan, vendosjen e kontakteve me gjithë kryepaqësitë e fshatrave që janë afër sipërfaqes pyjore.
- 2- Ngritja e skuadrave zjarrfikëse.
- 3- Kemi përcjellë pranë Njesisë Administrative Paskuqan hartën e riskut për zjarret në Pyje.

- 4- Është përcjellë pranë Drejtorisë së Mbrojtjes nga zjarri harta e sipërfaqeve pyjore dhe është kërkuar angazhimi i mjeteve dhe burimeve njerëzore.
- 5- Hartimi i planit të mbarështimit për sipërfaqet Pyjore që kemi në pronësi brenda muajt Gusht 2025.

**Ky Plan Masash është Hartuar nga grupi i punës ngritur me udhër nr.459, datë 30.06.25.
Grupi i Punës.**

Drejtore i Kadastrës, Bordi i Kullimit, Pyje & Kullota.

Elton Cerri

Administratori i Njesisë Paskuqan

Eduart Bodini

Drejtore i Drejtorisë së Mbrojtjes nga zjarri.

Bardhyl Gjana

Drejtore i Drejtorisë së Emergjencave Civile .

Teuta Cami

Specialist pranë Drejtorisë së Kadastrës, Bordi i Kullimit, Pyje& Kullota

Hamdi Hoti

**KRYETARI
Rakip SULI**

